



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:027400

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625685

KPPP.nr. 160/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Hib Petrol” SH.P.K. me numër unik të identifikimit 810662834, me adresë në Magj. Ferizaj-Prishtinë, përfaqësuar nga A.K. dhe G.V., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 756/2023 të datës 04.12.2023, të Përmbaruesit Privat Sheremet H.Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Hib Petrol” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbarimor P.nr. 756/2023 të datës 04.12.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Sheremet H.Livoreka, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Inspektorati i Punës” ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 756/2023 të datës 04.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 301/2023 të datës 29.07.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 7,000.00€ (shtatë mijë euro) me kamatë ligjore duke filluar prej paraqitjes së propozimit për ekzekutim, deri në pagesën përfundimtare, me ndalim të qarkullimit të mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK, ose pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës së cekur më lartë në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se propozimi për përmbarim nuk përmban elementet e kërkuara sipas nenit 38, par. 1 të Ligjit NR. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore. Tutje ka

shtuar se debitori nuk e ka të qartë se cili është dokumenti përmbarues pasi që në urdhërin përmbarimor P.nr. 756/2023 të datës 04.12.2023 janë bashkangjitur dy vendime. Ndërlidhur me këtë, ka shtuar se vendimet e bashkangjitura në urdhërin përmbarimor nuk kanë titull ekzekutiv dhe se nuk i plotësojnë kushtet e parapara me ligj, duke konsideruar lejimin e përmbarimit si të kundërligjshëm. Debitori ka theksuar se ka paraqitur padi pranë Departamentit Administrativ të Gjykatës Komerciale lidhur me anulimin e vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.512/2023 si vendim i shkallës së dytë për këtë çështje. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anuloj Urdhërin Përmbarimor P.nr. 756/2023 të datës 04.12.2023.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti përmbarimor Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr. 301/2023 të datës 29.07.2023, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”* ngase Vendimi Nr. 301/2023 të datës 29.07.2023 i marrë nga Inspektorati i Punës nuk përmbajnë vulën e përmbarueshmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të shfuqizohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.160/24, datë 26.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.